REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIK OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPSHTINA LIPLJAN
MUNICIPALITYOF LIPJAN

DREJTORATI PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM

Datë:	**08.04.2020**
References:	
Për :	**z. Imri Ahmeti** - Kryetar i Komunës së Lipjanit
Kopje :	**z. Fauz Xhemjali** - Nënkryetar i Komunës **z. Lulzim Qerimi** – Nënkryetar për Komunitete Arkiven
Nga:	Bekim Shabani - Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim
Lënda:	**RAPORT -- Mars - 2020**

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë këtij muaji në Drejtoratin për Ekonimi dhe Zhvillim janë realizuar detyra dhe obligime, si dhe aktivitete që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet tjera sektoriale, udhëzimet, urdhëresat, statuti dhe rregulloret tjera komunale, si dhe obligime të tjera nga e drejta pozitive në përgjthesi.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

- Për shkak të pandemisë Covid-19, shumica e takimeve me përfaqësues të organizatave të huaja dhe vendore janë nuk janë mbajtur, dhe janë pezulluar,
- Së bashku me komisionin e caktuar nga kuvendi komunal kemi hapur ofertat e ankandit publik të pronave paluajtëshme të komunës Z.K Gadime e Ulët dhe Babush i Muhaxherëve,

dhe pas takimit të parë të tjera takime i kemi pezulluar për shkak të pandemisë Covid – 19, deri në një vendim të radhës.

- Kemi mbajtur dëgjimin publik për draft rregullorën për orarin e punës së subjekteve afariste në prani të 62 pjesëmarrësve, ku kemi marrë rekomandimet vërejtjet dhe sygjerimet nga të pranishmit.
- Jemi duke përcjellur dhe faturuar qeratë, njëashtu kemi përcjellur raportin shërbimit juridik për muajin shkurt për pagesat.
- Ju kemi dërguar të gjitha drejtorive shkresë për përcjelljen e shënimeve të cilat i posedojne ku kemi kërkuar dhënjën e shënimeve si nga Investimet kapitale, subvencionet, hapësirat e gjelbërta, parkingjët, kanalizime, ujësjellëse etj, për krijimin e një databaze në DEZH,
- Ju kemi dërguar shkresë OJQ-ve të cilat janë bashkëfinancuar nga Komuna e Lipjanit për pezullimin e aktivitetve të tyre, si pasoj e COVID-19.
- Së bashku me DI jemi angazhuar dhe kordinuar duke përcjellur gjendjen e bizneseve dhënjene e rekomandimeve për masat që duhën të ndermerrën si pasoj e Covid-19.

STATISTIKAT

Zyra për regjistrim të Bizneseve,

1.	**Biznese të reja të regjistruara**	**10**
2.	**Shuarja e bisneseve**	**2**
3.	**Lëndë të refuzuar**	**0**
4.	**Ndrrimi i Çertefikatave të Bizneseve**	**25**

DISKUTIME PUBLIKE

- Gjatë këtij muaji kemi patur një dëgjim publik, për rregullorën e orarit të punës për subjektet afariste.

TAKIME TJERA

- Takim me përfaqësuesit të projektit sfidat e mileniumit, tema: Implementimi i projektit renovimi i objekteve shumë banesore në qytetin e Lipjanit.

SFIDAT

- **Duke i përcjellur rekomandimet nga Instituti i Shëndetësisë dhe institucioneve të tjera për pandeminë Covid-19, jemi duke punuar me staf të reduktuar dhe duke punuar konform këtyre rekomandimve kemi hasur në sfida në realizlimin e detyrave dhe takimeve të ndryshme, si pasoj e pandemisë Covid-19.**

REKOMANDIME

QËSHTJE TË TJERA

- Jemi në kontakt të vazhdueshëm me ministritë e linjës dhe masat e marrura nga këto ministri sa i përket vendimeve, planeve operacionale për pako stimuluese për biznese dhe punëtorë, dhe në të njejtën kohe po mundohemi të informojmë në kohë reale në mënyra të ndryshme bizneset dhe palët e interesit.